




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE  
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. Dep. 2-D/DPK  
 Nr. i faq. Broj stranica Nr. pages 02  
 Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 01-775/16  
 Data Datum Date 26-02-2016  
 PRISHTINE



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 26.02.2016, mori:

**V E N D I M**

**I. Mbyllet rastin me Nr. AKK-03-02-4193-15, për Zyrtarin e lartë, z. Islam Pacolli – Këshilltar komunal në Kuvendin e Prishtinës, për shkak se zyrtari i lartë publik z. Pacolli ka dhënë dorëheqjen nga funksioni i tij – Këshilltar Komunal në Kuvendin e Prishtinës, për të vazhduar të ushtroj funksionet e tija menaxhuese në biznese private.**

**II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.**

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-4193-15, për Zyrtarin e lartë, z. Islam Pacolli–Këshilltar komunal në Prishtinë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në disa biznese private, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Pacolli është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (Z.D./DPK-01-4376/15), pas të cilës ai ka kontaktuar zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z. Pacolli është deklaruar se nuk e ka ditur se kjo paraqet konflikt interesi edhe për nivelin e Këshilltarëve komunal, por është zotuar se brenda afatit do t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në biznes për të shmangur situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Ndërkohë, ai, në Agjencinë kundër Korrupsionit, ka sjell informatat mbi bizneset (DPK/DPKI-03-02-4835/15), nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK), në të cilat shihet se te bizneset. Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar “Korniza Disign” sh.p.k..

N.t.p.”Korniza-design”, Agjensioni Turistik “Diamond Travel” dhe D.P.H.”Diamond Diplomantik Bar”, z.Pacolli tashmë është hequr nga e drejta e të qenurit person i autorizuar.

Mirëpo kjo nuk ka ndodhë edhe me dy biznese tjera, N.P.N.”Mabetex Project Engineering” dhe “Mabco Construction” sh.p.k. këto ndryshime të nevojshme nuk janë bërë.

Për këtë Agjencia kundër Korrupsionit ka qenë e obliguar që konform Ligjit (Neni 18, paragrafi 5) palës t’i bëjë edhe shkresën e dytë (Paralajmëruese) me të cilën zyrtarit të lartë i është dhënë afati i caktuar ligjor për shmangie edhe të këtyre dy situatave të konfliktit të interesit (Akk-03-02/DPK-01-454/16).

Në ndërkohë, në Agjencinë kundër Korrupsionit zyrtari i lartë ka sjellur një shkresë zyrtare (DPK/DPKI-03-02/677/16) me të cilën shihet se z.Pacolli i është drejtuar Kryesuesit të Kuvendit Komunal në Prishtinë (01-031-40392), duke dhënë dorëheqje nga funksioni i tij publik – Anëtar i Kuvendit Komunal në Prishtinë.

Me këtë akt të dorëheqjes nga funksioni i zyrtarit të lartë publik (Këshilltar komunal), Agjencioni kundër Korrupsionit ka konstatuar se z.Pacolli tashmë nuk ushtron asnjë funksion prej zyrtari të lartë publik dhe kështu ka pushuar edhe situata e konfliktit të interesit që lidhet me funksionet e tija në sektorin privat.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

